



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenas /Glllogoc
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/03-S3173 dt. 17/12/ 2025

Në bazë të nenit 44 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34,37 të Statutit të Komunës së Drenasit, Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 Për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, neni 6, me kërkesë të Kryetarit të Komunës përmes Email-it. Kuvendi i Komunës me dt. 24.12.2025 (ditë e mërkurë) duke filluar në ora 12:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Thërret

Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.
2. Propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi.
3. Plani i punës të Kuvendit Komunal për vitin 2026.
4. Plani i Punës së Kryetarit dhe drejtorive komunale për vitin 2026.
5. Plani Lokal i veprimtari në mjedis 2025-2029.
6. Hartimi i planit Lokal për strategji të cilësisë së ajrit – Komuna e Drenasit 2025-2029.
7. Plani komunal për integritet i Komunës së Drenasit i përditësuar për vitin 2026.
8. Plani i Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për Komunën e Glllogocit 2026–2029
9. Plani i Reagimit Emergjent (PRE) për Komunën e Glllogocit.
10. Raport për zbatimin e planit të integritetit për Komunën e Drenasit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025.
11. Raport për zbatimin e planit të integritetit për Komunën e Drenasit për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2025.
12. Lista e rreziqeve komunale për vitin 2026.
13. Raporti i vlerësimit të menaxhimit të rreziqeve të Komunës së Drenasit për vitin 2025.
14. Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKSBB-së për periudhën Janar-Dhjetor 2025
15. Diskutimi i Raportit të Përformancës Komunale për vitin 2024.

Drenas, më 17.12.2025



Kryesuesi i Kuvendit të Drenasit

Burim Bujupi

Kërkesë për thirrje të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal

Ramiz Lladrovci

Wed 12/17/2025 2:58 PM

Liridona Ajazi; Burim Bujupi

Arben N. Shala; Skender Berisha

Label: DelTenYOldEm (10 years, 2 months, and 10 days) Expires: 2/23/2036 2:58 PM

Të nderuar,

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht neni 44, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 Për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, neni 6, kërkoj nga Sekretaria e Kuvendit Komunal të thërras mbledhje të jashtëzakonshme.

Kjo kërkesë vije për arsye të shqyrtimit dhe miratimit të disa pikave të nevojshme që kërkohet të trajtohen gjatë këtij viti, ku disa prej tyre shërbejnë për Grantin e Performancës Komunale.

Me Respekt,

Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës së Drenasit

E-mail: ramiz.lladrovci@rks-gov.net; rlladrovci@gmail.com

Cel:+383 (0) 49 977 999;

Tel:038 200 40 800

Adresa:Rr.Fehmi e Xhevë Lladrovci p.n

13000 Gillogoc-Drenas



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-030/01-52426 dt. 11/12/2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 53 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, 7, 8, 9 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 17.12.2025 propozoi këtë:

PROPOZIM VENDIM
Për themelimin e Komitetit për Komunitete

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës themelimi i Komitetit për Komunitete në këtë përbërje:

1. _____ -Anëtarë;
2. _____ -Anëtarë;
3. _____ -Anëtarë;
4. _____ -Shoqëria Civile;
5. _____ -Komuniteti i biznesit.

Neni 2

Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha çështjeve të parapara me nenin 53.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 3

ARSYETIM

Themelimi i komiteteve të përhershme është përcaktuar me nenin 51 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe me nenin 3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë.

Komiteti për Komunitete themelohet dhe është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, si dhe dokumentet e planifikimit strategjik; kornizën vjetore buxhetore afatmesme; planin vjetor të prokurimit; rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat; buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-400/01-52430 dt. 11/12 2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kryetari i Komunës kërkon nga Kuvendi Komunal të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në këtë përbërje:

- Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës (Kryesues)
- Laureta Thaqi, Koordinator i KKS-së;
- Driton Morina, Komandant i Stacionit Policor në Drenas
- Eset Bajraktari, përfaqësues i bashkësisë fetare Islame
- Meriton Sopi, përfaqësues i bashkësisë fetare Katolike
- ,përfaqësues i Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës
- Zahrie Podrimqaku-Subashi, Zyrtare për Barazi Gjinore
- Muhamet Gjoka, Drejtor i Drejtorisë për Arsim
- Arben Haziri, përfaqësues i Këshillit të Prindërve të Arsimit
- Ymerdin Hasani, përfaqësues nga FSK
- Arben Nika, kryesues i Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi
- Afrim Gjeli, përfaqësues nga Sektori i Emergjencave
- Afije Veseli, përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Kadire Tahiraj, përfaqësuese e OJQ "QPDG"
- Bajram Ramadani, përfaqësues nga komuniteti i biznesit
- Andi Binaku, përfaqësues nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara (HANDIKOS)
- Anita Curri, përfaqësuese nga Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL)

Neni 2

Detyrat dhe Përgjegjësit e KKSB-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Neni 3

Mandati i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është katër (4) vjeçar, ashtu sikurse anëtarët e Kuvendit, si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është përcaktuar me nenin 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenin 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi themelohet dhe është përgjegjës për përgatitjen e planit vjetor të punës dhe zhvillimin e projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi; identifikimi i dukurive negative që tentojnë të prishin sigurinë publike dhe rekomandojë planet e veprimi; bashkëpunimi me policinë në parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi; bashkëpunimi me institucionet qendrore që merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi; lidhja marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi që i tejkalojnë kufijtë e komunës së tyre; të kërkojë nga Kuvendi Komunal i Komunës, financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë; përmes komunës të kërkojë nga ndonjë organizatë jo qeveritare financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë; fton në takimet e tyre përfaqësuesit e MPB-së- DSB; fton përfaqësues nga institucionet qeveritare, të mediave ose përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që të marrin pjesë në takime të KKSB-së; kërkon nga policia përgjigje për rastet që janë me rëndësi për sigurinë e bashkësisë, duke mos ndërhyrë në procesin e hetimeve policore; mbajtja e takimeve të rregullta, ashtu siç përcaktohet në nenin 11 të këtij udhëzimi administrativ.



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 030/01-53168 dt. 17 / 12 / 2025

PLANI I PUNËS

SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN
2026

Dhjetor, 2025

PLAN I PUNËS

SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2026

Pasqyra e planit

Parathënie.....	02
Janar.....	05
Shkurt.....	06
Mars.....	07
Prill.....	08
Maj.....	09
Qershor.....	10
Korrik.....	11
Gusht.....	12
Shtator.....	13
Tetor.....	14
Nëntor.....	15
Dhjetor.....	16

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Punën dhe aktivitetin e vet e mbështet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe akte të tjera nënligjore, rregullore në fuqi si dhe udhëzimeve administrative. Siguron kushte të punës për seanca të Kuvendit, si dhe pjesëmarrje për qytetarët gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve, për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe çdo gjë në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Funksionimi i kuvendit të komunës

Kuvendi i komunës funksionon në bazë të këtij ligji, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore. Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për: a) statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre, b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese; c) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullore së punës; d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor; e) themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij Ligji; f) zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës; g) niveli i tarifave dhe ngarkesave; h) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi; i) emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike; j) arrijtjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale; k) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës dhe përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj. Për marrjen e vendimeve, kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit të kuvendit të komunës, apo kryetarit të komunës. Kuvendi i komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i Komunës kryen edhe funksione të tjera dhe detyra të pa deleguara:

- Miraton Planin Vjetor të Punës
- Themelon komisione sipas ligjit
- Merr vendime për krijimin dhe përdorimin e dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi
- Bën emërimin, riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike
- Arrin marrëveshje ndër komunale dhe brenda komunale
- Merr vendime për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës, si dhe përgjegjësit të tjera të përcaktuara me ligj.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Drenasit për vitin 2026

Plani i punës së Kuvendit ka për qëllim planifikimin paraprak të punës për vitin 2026 dhe i bashkërenditur me aktivitetet e Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2026. Plani i Punës e përmbledh punën një vjeçare të Kuvendit, duke përfshirë të gjitha punët dhe aktivitetet, ndërsa çështjet të cilat nuk mund të planifikohen dhe dalin si nevoja për shqyrtim në Kuvend, do të trajtohen sipas ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit të Komunës së Drenasit dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit. Në këtë mënyrë, në Planin e Punës janë paraparë 11 mbledhje të rregullta që do të mbahen për vitin 2026 mbledhjet do të mbahen javën e fundit të çdo muaji, përjashtimisht në rast kur mund të përcaktohet ndryshe.

Kryesuesi i kuvendit të komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e kuvendit të komunës. Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e Punës. Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet: a) data e mbajtjes së mbledhjes; b) koha e mbajtjes së mbledhjes; c) vendi i mbajtjes së mbledhjes; d) rendi i ditës për mbledhje; dhe e) materialet e mbledhjes. f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës mbanë:

1. Mbledhje inauguruese
2. Mbledhje të rregullta
3. Mbledhje të jashtëzakonshme
4. Mbledhje urgjente
5. Mbledhje solemne.

Fresa për mbledhjen inauguruese i dërgohet shtatë (7) ditë punë para mbajtjes së mbledhjes anëtareve të kuvendit dhe autoritetit mbikëqyrës.

Në raste të veçanta fresa mund të dërgohet tre (3) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

Ftesa për mbledhjen e rregullt i dërgohet shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes anëtareve të kuvendit dhe autoritetit mbikëqyrës.

Ftesa për mbledhjen e jashtëzakonshme i dërgohet tre (3) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes anëtareve të kuvendit dhe autoritetit mbikëqyrës.

Ftesa për mbledhjen e urgjente procedurat për thirrjen e mbledhjes nuk zbatohen si në rastet e thirrjes së mbledhjeve të tjera të kuvendit të komunës, mbledhja urgjente thirret në rast të fatkeqësisë natyrore dhe rrethanave tjera urgjente në komunë.

Planifikimi i mbledhjeve të KK –së dhe çështjet që do të trajtohen gjatë vitit 2026

Shtojcë:

Plani i punës sipas muajve

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2026

JANAR 2026

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2025	DF	Kryetari i Komunës	14.01.2026	KPF 21.01.2026	30.01.2026	Viti i Ri
2.	Raporti i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2025.						
3.	Raportet e Komiteteve Konsultative në KPF	Komitetet Konsultative	Kuvendi i Komunës	14.01.2026	KPF 21.01.2026	30.01.2026	
4.	Raporti i punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit për vitin 2025 dhe plani i implementimit të rekomandimeve						
5.	Raporti i performancës komunale						
6.	Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi						
7.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.						

8.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	14.01.2026	KPF 21.01.2026	30.01.2026	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2026

SHKURT 2026

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.	Drejtoritë profesionale	Kryetari i Komunës	09.02.2026	KPF 16.02.2026	26.02.2026	17.02.2026
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	09.02.2026	KPF 16.02.2026		MBLEDHJE SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR

		Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës			KPF 16.02.2026		NDERËTË 17 SHKURTIT, DITËS SË SHPALLJES SË PAVARSISË SË KOSOVËS

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2026

MARS 2026

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend AKTIVITETET Afati kohor	05.03.2026
		Dytësor	Parësor				
1.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	12.03.2026	KPF 19.03.2026	30.03.2026	Mbledhje Solemne e Kuvendit të Komunës Drenas kushtuar "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Rënies Heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të
2.	Trajtimi i çështjeve të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	12.03.2026	KPF 19.03.2026	30.03.2026	
3.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2026

PRILL 2026

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti financiar për tre mujorin e vitit 2026	DF	Kryetari i Komunës	15.04.2026	KPF 22.04.2026	30.04.2026	9 Prill Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	15.04.2026	KPF 22.04.2026	30.04.2025	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2026

MAJ 2026

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Informmat lidhur me qarkoren Buxhetore 2026 dhe planifikimi i veprimit për dëgjime Publike	DF	Kryetari i Komunës	13.05.2026	KPF 20.05.2026	29.05.2026	1 Maj Dita Ndërkombëtare Punës
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	13.05.2026	KPF 20.05.2026	29.05.2026	9 Maj Dita e Evropës
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2026

QERSHOR 2026

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Draft – korniza afatmesme buxhetore (KAB) për vitet 2027-2028	DF	Kryetari i Komunës	15.06.2026	KPF 22.06.2026	30.06.2026	MBLEDHJEN SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR NDERË TË 14 QERSHORIT, DITËS SË ÇLIRIMIT TË DRENASIT
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	15.06.2026	KPF 22.06.2026	30.06.2026	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2026

KORRIK 2026

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti gjashtë mujor i Kryetarit të Komunës së Drenasit për vitin 2026	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	15.07.2026	KPF 22.07.2026	30.07.2026	
2.	Raporti i Auditorit të Jashtëm për vitin 2025 për Komunën e Drenasit (Glllogocit)		Kryetari i Komunës	15.07.2026	KPF 22.07.2026	30.07.2026	
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës				
4.	Raporti Financiar Janar-Qershor 2026.						
5.	Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal Për Siguri në Bashkësi.						

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2026

Gusht, Pushim 2026

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2026

SHTATOR 2026

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Shqyrtimi i Draft -Buxhetit final, dhe marrja e vendimit për buxhet për vitet 2026-2027	DF	Kryetari i Komunës	15.09.2026	KPF 22.09.2026	30.09.2026	
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	DF	Kryetari i Komunës	15.09.2026	KPF 22.09.2026	30.09.2026	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2026

TETOR 2026

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraparak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITET ET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti janar-shtator i realizimit të buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2026	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	15.10.2026	KPF 22.10.2026	30.10.2026	
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	15.10.2026	KPF 22.10.2026	30.10.2026	

NËNTOR 2026

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraparak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Informatë nga Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit rreth realizimit të përfundimit të projekteve kapitale në teren	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	12.11.2026	KPF 19.11.2026	27.11.2026	28 Nëntor SEANCË SOLEMNE TË KUVENDIT TË

2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	12.11.2026	KPF 19.11.2026	27.11.2026	KOMUNËS ME RASTIN E FESTËS SË 28 NËNTORIT, DITËS SË FLAMURIT, DITËLINDJES SË KOMANDANTIT LEGJENDAR ADEM JASHARI
3.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2026

DHJETOR 2026

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITE TET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2027	Kryetari i Komunës	Kuvendi i Komunës	10.12.2026	KPF 17.12.2026	25.12.2026	
2.	Plani i Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2027	Drejtoritë përkatëse	Kryetari i Komunës	10.12.2026	KPF 17.12.2026	25.12.2026	
3.	Lista e rreziqeve për vitin 2027	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	10.12.2026	KPF 17.12.2026	25.12.2026	

4.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët								
----	---	--	--	--	--	--	--	--	--

Kuvendi i Komunës së Drenasit ka planifikuar që gjatë vitit 2026, të mbajë gjithsej 11 mbledhje të Planit të bashkëngjishim edhe orarin e takimeve që do të mbahen për secilin muaj.

DRENAS – 17.12.2025



Lindona Fejza Ajazi



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 030/01-53168 dt. 17/12/2025

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, të Statutit të Komunës së Drenasit, dhe rregullores për punën e Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2026 planifikoi këtë: Orari i mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe i mbledhjeve të Kuvendit Komunal për vitin 2026.

Janar Mbledhja e KPF-a me dt. 21.01.2026 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 30.01.2026	Shkurt Mbledhja e KPF-a me dt: 16.02.2026 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 26.02.2026	Mars Mbledhja e KPF-a me dt. 19.03.2026 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 30.03.2026
Prill Mbledhja e KPF-a me dt. 22.04.2026 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 30.04.2026	Maj Mbledhja e KPF-a me dt. 29.05.2026 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 20.05.2026	Qershor Mbledhja e KPF-a me dt. 22.06.2026, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 30.06.2026
Korrik Mbledhja e KPF-a me dt. 22.07.2026, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt.30.07.2026	Gusht PUSHIM	Shtator Mbledhja e KPF-a me 22.09.2026, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK-al me 30.09.2026
Tetor Mbledhja e KPF-a me 22.10.2026 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 30.10.2026	Nëntor Mbledhja a e KPF-a me 19.11.2026, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK-al me 27.11.2026	Dhjetor Mbledhja e KPF-a me 17.12.2026, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK-al me 25.12.2026

DRENAS, 17.12.2025